



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 1427/Prot

Tiranë, më 11 05 /2021

Lënda: Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE _____

**DREJTORISË RAJONALE TË OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL
PUBLIK _____**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit të Kryeministrit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” i ndryshuar me Urdhërin nr.107, datë 13.08.2020 dhe shkresës nr.160/1 prot, datë 07.05.2021 “Njoftim për vend të lirë pune (mundësi për lëvizje paralele)” të Drejtorisë Rajonale të Ofritit të Formimit Profesional Publik Nr.1 Tiranë, protokolluar në AKPA me nr.1427 prot, datë 07.05.2021,

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton shpalljen e procedurave të **lëvizjes paralele** për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik, në Drejtorinë Rajonale të Ofritit të Formimit Profesional Publik Nr.1 Tiranë, për pozicionin :

- 1 mësimdhënës i formimit teorik-praktik (part-time) në kursin riparim kompjuteri
Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik në Drejtorinë Rajonale të Ofritit të Formimit Profesional Publik Nr.1 Tiranë:

Aplikanti për mësimdhënës të formimit teorik-praktik, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojnë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik si vijon:

- a) të ketë minimalisht diplomë nga një shkollë e mesme profesionale/ pas të mesëm, kualifikim profesional mbi një vit në fushën/profesionin që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të formimit profesional;
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën është arsimuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

1. Vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentave

Aplikantët duhet të dorëzojnë kërkesën për lëvizje paralele dhe dokumentacionin përkatës i cili duhet të jetë i njehsuar me origjinalin ose origjinal, pranë Drejtorisë Rajonale të Ofritit të Formimit Profesional Publik Nr.1 Tiranë, brenda 5 ditëve nga njoftimi. Afati i njoftimit fillon më datë 14.05.2021.

Nëse nuk paraqiten kërkesa për lëvizje paralele brenda afatit të mësipërm, Drejtoria Rajonale e Ofritit të Formimit Profesional Publik Nr.1 të fillojë procedurën për shpalljen e vendit të lirë, për pozicionin:

- 1 mësimdhënës i formimit teorik-praktik (part-time) në kursin riparim kompjuteri në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.

Drejtorja Rajonale e Ofritit të Formimit Profesional Publik Nr.1 Tiranë brenda 5 ditëve pune pasi është mbyllur procedura e lëvizjes paralele dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë për lëvizje paralele, shpall njoftimin për vendin e lirë në faqen zyrtare të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të Drejtorisë Rajonale të Ofritit të Formimit Profesional Publik Nr.1 Tiranë, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Drejtorisë Rajonale të Ofritit të Formimit Profesional Publik Nr.1 Tiranë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Elira DEMIRAJ

